



Tiranë, 26 shkurt 2019

“Mbi vazhdimin e reformës në Akademinë e Shkencave, kodin e etikës dhe shkencën në përgjithësi”

(aprovuar në mbledhjen e Asamblesë së Ash-së, date 26 shkurt 2019)

Prej një viti e gjysmë Akademia e Shkencave është përfshirë në një proces reformimi të saj dhe të kërkimit shkencor në tërësi.

Ky proces u ndërmor pas një debati trevjeçar mbi gjendjen në Akademinë e Shkencave dhe në kërkimin shkencor në vend, për rolin dhe misionin e Akademisë së Shkencave, për organizimin dhe reformimin e saj, për të kryer sa më mirë funksionet e veta në nxitjen dhe promovimin e kërkimit shkencor, vlerësimin e arritjeve më të mira dhe të kontribuesve më të spikatur.

Veçanërisht si bazë për reformën u morën platformat e paraqitura nga Akademia e Shkencave përgatitur nga grupet e ngritura posaçërisht a nga anëtarë të veçantë të saj; si dhe detyrat e lëna nga Kryeministri në takimet e zhvilluara me këtë rast.

Pas marrëveshjes midis Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve dhe Akademisë së Shkencave për të bashkëpunuar për hartimin e bazës ligjore të reformës në këtë institucion e më gjerë, pas një pune 9-mujore, u arrit në formulimin e dy projektligjeve: për Akademinë e Shkencave dhe për Etikën në kërkimin shkencor.

Projektet morën mbështetjen e organizatës më kompetente dhe më prestigjioze, akademike europiane ALLEA dhe të komunitetit akademik të institucioneve shkencore e universitare të vendit. Vërejtjet dhe sugjerimet e tyre u reflektuan në to.

Me dërgimin e tyre për miratim përfundimtar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (prill 2018) dhe më tej pranë Këshillit të Ministrave (shtator 2018), faza e parë e reformës konsiderohet e përfunduar, duke hapur rrugën për hedhjen e hapave të mëtejshëm për realizimin e plotë të saj, si dhe për bashkëpunim e kontribut të

mëtejshëm të Akademisë së Shkencave për formalizimin e reformës në kërkimin shkencor dhe thellimin e reformimit në arsimin e lartë.

Faza e parë quhet e përfunduar pasi:

- Akademia e Shkencave *nuk është më institucioni mbi të cilin bëhej presion për reformim dhe shihej si bllokuese e procesit*. Ajo tashmë e ka kryer detyrën e saj për hartimin e projektligjeve përkatëse dhe ka dëshmuar qartazi se ofrohet për bashkëpunim me Këshillin e Ministrave për ta përmbyllur me sukses procesin e reformimit, duke evituar vonesat e mëtejshme dhe duke tejkaluar çdo faktor frenues të këtij procesi;
- Projektligji për Akademinë e Shkencave u ka rezistuar kritikave dhe garanton organizimin dhe funksionimin e saj sipas standardeve europiane;
- Gjatë këtij procesi u arrit një qendrim e vlerësim i përbashkët përfundimtar dhe i pakontestueshëm për *domosdoshmërinë e vazhdimin të Akademisë së Shkencave, për reformimin dhe jo shkrirjen apo shpërndarjen e saj*; si dhe morën përgjigje të qartë ligjore përpjekjet për të servirur si reformë praktika të dështuara si ato të vitit 2008;
- Iu dha zgjidhje pozitive ligjore edhe debatit të vulgarizuar për një Akademi Shkencash "me apo pa institute", duke pranuar përfundimisht se *Akademia e Shkencave duhet të ketë edhe rol aktiv në kërkimin shkencor në vend, nëpërmjet drejtimit të projekteve të caktuara apo njësive të kërkim-studimit, të ngritura sipas mundësive, nevojave dhe vizioneve të kohës*;
- Me paraqitjen në formë projektligji të kodit të etikës në kërkimin shkencor, shoqëruar me procedurat e verifikimit dhe penalizimit të plagjiaturës, fabrikimit apo falsifikimit në marrjen e gradave dhe titujve shkencorë të pamërituar, Akademia e Shkencave e vendos veten në pozitën e një institucioni avantgardë për të luftuar inflacionin në fitimin e gradave dhe titujve shkencorë, për rikthimin e dinjitetit në qarqet akademike nëpërmjet proceseve ligjore të pastrimit. Kështu ajo kthehet siç i

takon në rolin e nxitësit dhe kontribuesit kryesor për pastrimin në të gjitha hallkat e nivelet e kërkimit;

- Pranimi në parim, në të gjitha hallkat, i disa ndryshimeve të parashikuara në projektligjin për Akademinë e Shkencave, të vlerësuara nga Kryeministri si "elementë që janë realisht të kërkuara nga koha tashmë prej shumë vitesh dhe përbëjnë sigurisht një gur themeli për ecurinë e Akademisë", siç janë: vendosja e kriterëve dhe procedurave sa më rigorozë për pranimet e anëtarëve të rinj, mbështetur mbi indeksime e rankime të certifikuara qartë, me pjesëmarrjen e institucioneve kryesore të arsimit dhe shkencës; rritja e transparencës në organizimin dhe funksionimin e Akademisë së Shkencave nëpërmjet komisioneve dhe mbledhjeve të hapura; ngritja e njërive të kërkim-studimit shkencor sipas mundësisë, nëpërmjet bashkëpunimit institucional me Këshillin e Ministrave dhe me institucionet e arsimit të lartë e ato të kërkim-studimit shkencor; si dhe korregjimi ligjor i pasojave negative të vitit 2008 (heqja e së drejtës së votës me kriterë moshore, për të ndikuar politikisht), bëjnë të mundur që gjithë sa më sipër të bëhen të zbatueshme nëpërmjet hartimit të statutit të ri dhe me rregullore të reja;

- Nëpërmjet akteve nënligjore është plotësisht e mundur të realizohet një reformim i brendshëm në Akademinë e Shkencave në ngritjen e transparencës, të efektivitetit e të mirëfunksionimit të Kryesisë dhe të aparatit administrativ të Akademisë së Shkencave.

Mbështetur në sa më sipër Akademia e Shkencave vlerëson se për kryerjen e plotë të reformës së saj dhe të kërkimit shkencor në tërësi duhen hedhur këto hapa, që i takojnë fazës së dytë:

- Asambleja e Akademisë së Shkencave rikonstituohet bazuar në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese, interpretuar në mënyrë përfundimtare nga Gjykatë Administrative e Tiranës;

- Akademia e Shkencave kryen zgjedhjet brenda afitit 3 mujor të urdhëruar nga ligji dhe ndryshimet në statut, për të legjitimuar dhe normalizuar funksionimin e saj konform ligjit, masë kjo e domosdoshme edhe për të rritur rolin e Akademisë në

përfundimin e kryerjes së reformës në kërkimin shkencor dhe për miratimin dhe zbatimin e ligjit për "pastrimin" dhe etikën në kërkimin shkencor;

- Asambleja e Akademisë së Shkencave, me legjitimitet të rikthyer, pas zgjedhjes së Kryesisë, miraton statutin e ri dhe rregulloret përkatëse brenda muajit qershor 2019;

- Pjesë kryesore e statutit të ri, të cilin Akademia e Shkencave do ta miratojë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe me institucionet e arsimit të lartë, është ajo për procedurat e kriteret për pranimet e reja;

- Pjesë e rëndësishme e rregulloreve të reja do të jetë reformimi i strukturave dhe i aparatit administrativ të Akademisë së Shkencave, duke përfshirë raportin dhe shkallën e përfshirjes së Kryesisë dhe anëtarëve të saj në Akademi;

- Akademia e Shkencave vazhdon bashkëpunimin me Këshillin e Ministrave për të përshpejtuar nismat juridike për miratimin e projektligjeve të reja, veçanërisht të atij për Akademinë e Shkencave;

- Akademia e Shkencave bashkëpunon me Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve dhe me institucionet e kërkim-studimit për debatimin për projektligjin për etikën dhe për projektligjin për shkencën, deri në miratimin e tyre përfundimtar;

- Akademia e Shkencave shpall vendet vakant që krijohen sipas ligjit dhe Vendimit të Gjykatës Kushtetuese: vendet që krijohen nga anëtarët që kanë mbushur a mbushin moshën 75 vjet dhe nga ata që janë ndarë nga jeta;

- Brenda muajit dhjetor të këtij viti bëhen pranimet për 10 anëtarë të rinj dhe brenda vitit 2020 plotësohen vendet e tjera vakante.